

VENDIM
Nr.878, datë 24.12.2019

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE RREGULLAT E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 14, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ngritjen dhe organizimin e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, si një organ ndërministror për bashkërendimin e punës së ministrive, institucioneve të tjera përgjegjëse si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, të ngarkuara nga akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për të gjitha veprimtaritë që lidhen me dhe që ndikojnë në përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

2. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit koordinon dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse, të ngarkuara nga akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për planifikimin e përdorimit të fondit të rindërtimit në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit, me qëllim përgatitjen e propozimeve që i përcillen për miratim Këshillit të Ministrave.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ato të përkufizuar në aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

KREU II
PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është një organ kolegjal, kryesohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- a) Ministrin e Mbrojtjes;
- b) Ministrin e Brendshëm;
- c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- dh) Ministrin e Kulturës;
- e) Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- ë) Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- f) Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- g) Kryetarin e Bashkisë Tiranë, me kërkesë të tij.

2. Në mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, me kërkesë të kryetarit, marrin pjesë pa të drejtë vote dhe përfaqësues të organeve të ndryshme publike, të biznesit, ekspertë/profesionistë të fushës së mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile ose drejtues të OJF-ve, me objekt veprimtarie mbrojtjen civile dhe ndihmën humanitare.

3. Vendimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit janë të vlefshme kur sigurohet pjesëmarrja e, të paktën, 2/3 të anëtarëve.

4. Në mungesë të kryetarit, mbledhjen e drejton një nga anëtarët e autorizuar nga kryetari ose anëtari më i vjetër në moshë.

5. Në rast të numrit të barabartë të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit të komisionit konsiderohet përcaktuese.

6. Votimi bëhet i hapur në prezencë të sekretarit të Komisionit, i cili mban procesverbal dhe regjistron votat e anëtarëve të Komisionit.

7. Sekretari i Komisionit caktohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin, ndër punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ose një punonjës tjetër i administratës publike, i cili nuk ka të drejtë vote dhe nuk nënshkruan në vendim.

8. Vendimet dhe procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Vendimet duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vota “kundër” duhet të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

9. Vendimet e komisionit përgatiten në dy kopje, të cilat mbahen në sekretariatit teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

10. Mbledhjet thirren me kërkesë të kryetarit ose kur e kërkojnë jo më pak se 1/3 e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

11. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u vihen në dispozicion anëtarëve të Komisionit, jo më vonë se 2 ditë nga data e mbledhjes.

12. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e Komisionit ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit përfaqësohet nga kryetari.

15. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit e ushtron veprimtarinë e tij sipas parashikimeve të këtij vendimi dhe, për aq sa është e mundur, në bazë të legjislacionit në fuqi për organet kolegjiale.

16. E gjithë veprimtaria administrative e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në cilësinë e sekretariatit teknik të tij.

17. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile përballon shpenzimet për funksionet e parashikuara nga ky vendim, nëpërmjet buxhetit të vet ose me financime nga fondi i rindërtimit, të financuara nga buxheti i shtetit, me miratim nga Këshilli i Ministrave.

KREU III VEPRIMTARIA E KOMISIONIT

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, ushtron këto kompetenca:

a) Harton dhe miraton programin e përgjithshëm të rindërtimit;

b) Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit;

c) Në konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonave të reja për zhvillim;

ç) Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit;

d) Propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;

dh) Monitoron periodikisht zbatimin e programit dhe të detyrave të caktuara njësisive zbatuese dhe përgatit raporte për Këshillin e Ministrave;

e) Përcjell dhe propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, projektvendimet që kanë të bëjnë me çështjet e adresuara nga njësitë zbatuese.

2. Programi i përgjithshëm i rindërtimit hartohet dhe miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, brenda 2 muajve nga shpallja e tij.

3. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit mund të kontrakttojë ekspertë gjatë hartimit të programit të përgjithshëm të rindërtimit, nëpërmjet procedurave të prokurimit, të parashikuara në kreun VI, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

4. Në funksion të përgatitjes së programit të përgjithshëm të rindërtimit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe çdo institucion tjetër përgjegjës, vë në dispozicion të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ose të ekspertëve të caktuar të dhënat dhe informacionet e nevojshme.

KREU IV

SEKRETARIATI TEKNIK I KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT

1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen funksionin e sekretariatit teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

2. Me vendim të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, pranë sekretariatit mund të angazhohen edhe specialistë dhe ekspertë të institucioneve të tjera, për trajtimin e çështjeve të caktuara teknike që kanë nevojë për ekspertizë në fusha të ndryshme.

3. AKMC-ja, përveç detyrave të përcaktuara në aktin normativ nr.9, datë 6.12.2019, ka këto përgjegjësi:

a) Administron të gjithë dokumentacionin që është objekt shqyrtimi dhe vendimmarrjeje në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit;

b) Merr masa për të njoftuar dhe organizuar mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit;

c) Ka përgjegjësi për të organizuar, drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe/ose vendor, me qëllim përgatitjen për shqyrtim dhe miratim të akteve në kompetencë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit;

ç). Përgatit projektaktet që do të miratohen nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, pas shqyrtimit të propozimeve të përcjella nga njësitë zbatuese, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e tjera qendrore apo iniciativave të drejtpërdrejta të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

4. Projektakti së bashku me dokumentacionin shoqërues përgatiten nga AKMC-ja dhe përpara miratimit, me nënshkrim të kryetarit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, i përcillet për mendim ministrive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, që nuk janë të përfaqësuara në Komision, fusha e veprimtarisë të cilave preket nga parashikimet e projektaktit.

5. Ministritë dhe institucionet e përcaktuara në pikën 4, të këtij kreu, përcjellin zyrtarisht mendimin e tyre për projektaktin, jo më vonë se 5 ditë pune nga data e marrjes së tij.

6. Projektakti, i cili, për aq sa është e mundur, ka pasqyruar vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara, jo më vonë se 2 ditë kalendarike nga thirrja e mbledhjes, u dërgohet dhe një herë për njohje anëtarëve të Komisionit.

7. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e anëtarëve të tjerë e të drejtuesve të institucioneve të interesuara, Kryetari paraqet projektaktin për shqyrtim pranë Komisionit Kombëtar të Rindërtimit, në datën dhe orën e përcaktuar.

8. AKMC-ja mban regjistër protokollin më vete për gjithë veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit kryen veprimtarinë e tij deri në rindërtimin dhe rehabilitimin e plotë të të dëmtuarve nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë e tjera.

2. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit konsiderohet i krijuar në mbledhjen e parë të tij, ku duhet të marrin pjesë të gjithë anëtarët. Ministri përgjegjës për rindërtimin thërret mbledhjen e parë të Komisionit. AKMC-ja, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për rindërtimin, merr masat për organizimin e kësaj mbledhjeje dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, pas përfundimit të funksionimit të tij, kalon në dorëzim të gjithë dokumentacionin përkatës në përgjegjësi të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministrit i Shtetit për Rindërtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama